



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **NDËRTIM**

#### **B-II-20**

**Niveli i dytë në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit II të KEK<sup>2</sup>**

**Tiranë 2020**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	NDËRTIM			Kodi B-II-20
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional në drejtimin “Ndërtim”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, është “zhvillimi i personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar, si ndihmës, në profesione që lidhen drejtpërdrejt me fushën e ndërtimit”.			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Ndërtim” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> <li>– kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;</li> <li>– janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional;</li> <li>– kanë aftësi ndryshe, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paftësitë që shfaqin.</li> <li>– Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucionet përgjegjëse përgatitin udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Ndërtim”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, pajis individin me Certifikatën e Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli, si punëtor gjysmë i kualifikuar në këtë fushë, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar si ndihmës në sipërmarrje të ndryshme ndërtimi ose sipërmarrje të tjera që kryejnë veprimtari në fushën e ndërtimit, si edhe në pika të shërbimeve teknike apo shërbimeve të shitjes në sipërmarrjet e ndërtimit.  Për sa i përket arsimimit të mëtejshëm, individi ka mundësi të vazhdojë studimet në kualifikime të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, në një prej profileve të drejtimit mësimor “Ndërtim”. Me vijimin e mëtejshëm të arsimit profesional në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
<b>Data e validimit</b>	<i>(kur të miratohet)</i>			
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	<b>B-I-16</b>			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

## NJOHURI

Në përfundim të kualifikimit profesional “Ndërtim” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale si më poshtë:

### NJOHURI TË PËRGJITHSHME TEKNIKE TË FUSHËS SË NDËRTIMIT

#### Vizatime teknike të ndërtimit

- Të përshkruajë rëndësinë dhe qëllimin e vizatimit teknik;
- Të lexojë simbolet, shenjat dalluese dhe shkrimin teknik që përdoren në vizatime të ndryshme të objekteve të thjeshta të ndërtimit;
- Të lexojë vizatime dhe skica me përmasa të ndryshme;
- Të përshkruajë shkallët e vizatimit të paraqitjes së trupave në vizatimin teknik;
- Të përshkruajë llojet e projeksioneve dhe rrafshet e projektimit;
- Të interpretojë pozicionin e përshtatshëm të modelit mësimor;
- Të interpretojë prerje dhe seksione për pjesë të ndryshme të modelit mësimor;
- Të interpretojë vizatime të elementeve përbërëse të planit të përgjithshëm;
- Të lexojë vizatime të ndryshme skematike
- Të interpretojë vizatime dhe skica detajesh, planimetrisë, pamjes, prerjes, planit të themeleve, për një ndërtesë të thjeshtë;
- Të lexojë vizatime të elementeve të thjeshta konstruktive.

#### Materiale ndërtimi

- Të rendisë vetitë kryesore të materialeve të ndërtimit dhe t'i dallojë ato;
- Të listojë materialet drusore dhe përdorimet e tyre në ndërtim;
- Të rendisë materialet metalike dhe të kombinuara që përdoren në ndërtim;
- Të listojë materialet prej guri natyror që përdoren në ndërtim;
- Të listojë materialet qeramike që përdoren në ndërtim;
- Të përshkruajë teknologjinë e prodhimit të materialet qeramike;
- Të përshkruajë materialet lidhëse joorganike dhe organike që përdoren në ndërtim dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë materialet gurore artificiale që përdoren në ndërtim;
- Të rendisë materialet përbërëse të betonit dhe recepturat e tyre
- Të përshkruajë vetitë e betonit, mënyrat e përgatitjes së tij dhe përdorimet e llojeve të ndryshme të tij;
- Të listojë llojet kryesore të elementeve të parapërgatitura betonarme
- Të rendisë materialet përbërëse të llaçeve dhe recepturat e tyre,
- Të përshkruajë mënyrat e përgatitjes së llaçeve;
- Të rendisë llojet e materialeve hidroizoluese, termoizoluese dhe akustike sipas cilësisë dhe përdorimit;

- Të listojë materialet prej xhami që përdoren në ndërtim;
- Të rendisë materialet plastike që përdoren në ndërtim;
- Të listojë materialet e bojatisjes, pigmentet, tretësit dhe lëndët lidhëse, sipas cilësisë dhe përdorimit.
- Të rendisë materialet e ndërtimit të sistemeve të thata në ndërtim dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë llojet e materialeve të ndërtimit që përdoren për punimet e konstruksionit mbajtës së një objekti ndërtimi;
- Të listojë llojet e materialeve të ndërtimit që përdoren për punimet e rifiniturës së një objekti ndërtimi;

### **Mekanikë ndërtimi**

- Të dallojë trupat e ngurtë, forcat, si dhe llojet e lidhjeve të tyre;
- Të përshkruajë kushtet e ekuilibrit të forcave plane;
- Të përshkruajë momentin e rrotullimit nga çifti i forcave paralele;
- Të përshkruajë kapriatat dhe forcat që lindin në shufrat e kapriatës;
- Të përshkruajë kuptimin e sforcimeve;
- Të dallojë sforcimet gjatë veprimit të forcave që veprojnë në një trup;
- Të listojë deformimet e trupave elastik;
- Të përshkruajë llojet e ngarkesave në trarin e drejtë;
- Të shpjegojë konceptin për momentin e përkuljes dhe forcën prerëse në një seksion të trarit të drejtë që punon në përkulje;
- Të përshkruajë përkuljen gjatësore të shtyllave;

### **Teknikë ndërtimi**

- Të listojë grupimet e objekteve të ndërtimeve dhe llojet e ndërtesave sipas funksionit të tyre;
- Të përshkruajë llojet e bazamenteve;
- Të përshkruajë llojet e përforcimit të bazamenteve artificiale;
- Të klasifikojë themelet sipas konstruksionit mbajtës të ndërtesës, ngarkesës, konfiguracionit dhe materialit të përdorur;
- Të klasifikojë muret sipas ngarkesës, pozicionit dhe materialit të përdorur;
- Të përshkruajë teknologjinë e ndërtimit të themeleve dhe mureve të llojeve të ndryshme;
- Të listojë elementet kryesore të ndërtesës;
- Të klasifikojë ndërkatet dhe shkallët sipas materialit dhe skemës konstruktive;
- Të përshkruajë teknologjinë e ndërtimit të ndërkateve dhe shkallëve me materiale të ndryshme;
- Të klasifikojë çatitë dhe mbulesat, sipas materialit dhe skemës konstruktive;
- Të klasifikojë tarracat sipas zgjidhjes së regjimit të nxehtësisë dhe lagështisë;
- Të përshkruajë teknologjinë e ndërtimit të nënshtresave të tarracave;
- Të përshkruajë teknologjinë e suvatimit të tavaneve dhe mureve të brendshme e të jashtme;
- Të përshkruajë teknologjinë e lyerjes në sipërfaqe të ndryshme të ndërtesës;
- Të përshkruajë teknologjinë e veshjes së mureve të brendshme dhe të jashtme (fasadave)

- me materiale të ndryshme;
- Të përshkruajë teknologjinë e nënshtresave të dyshemeve të llojeve të ndryshme;
- Të përshkruajë teknologjinë e nivelimit dhe shtrimit të dyshemeve tyre me materiale të ndryshme;
- Të përshkruajë radhën e punës për punime të prishjes në objekte ndërtimi;
- Të përshkruajë llojet e punimeve të rikonstruksionit dhe shtesave në objekte ndërtimi;
- Të përshkruajë llojet e punimeve të mirëmbajtjes së objekteve të ndërtimit;
- Të përshkruajë llojet e punimeve të shtresave rrugore;
- Të përshkruajë llojet e punimeve në kanalizime, tubacione;
- Të përshkruajë llojet e punimeve në gjurmime, mbushje e ngritje skarpatesh;
- Të përshkruajë llojet e punimeve në veprat e artit;

### **Makineri të ndërtimit**

- Të rendisë llojet e makinerive që përdoren për punime të ndryshme ndërtimi dhe prishje;
- Të përshkruajë përdorimet e mekanizmave të punimeve të ndërtimit;
- Të rendisë llojet e vinçave që përdoren në ndërtim;
- Të përshkruajë llojet e skelave që përdoren për punimet e konstruksionit mbajtës dhe të rifiniturës në një objekt ndërtimi;

### **Konstruksione ndërtimi**

- Të dallojë llojet e konstruksioneve sipas materialit të tyre;
- Të përshkruajë llojet e ngarkesave që veprojnë në konstruksione;
- Të përshkruajë markën e betonit dhe të armaturës së hekurit në tabelat përkatëse;
- Të interpretojë rezistencat e normuara dhe të njehsuara të betonit dhe armaturës së hekurit në tabelat përkatëse;
- Të interpretojë pozicionet e vendosjes së armaturës së hekurit në konstruksione prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë llojet e armaturës së hekurit dhe mënyrat e përpunimit të saj;
- Të përshkruajë llojet e armaturës e kallëpeve të betonit;
- Të lexojë tabelën e specifikimit të armaturës së hekurit;

### **Përgatitja e vendit të punës**

- Të përshkruajë mjetet e punës dhe instrumentet matëse, niveluese e gjeodezike që përdoren për punimet e konstruksionit mbajtës së një objekti ndërtimi;
- Të përshkruajë mjetet e punës dhe instrumentet matëse, niveluese e gjeodezike që përdoren për punimet e rifiniturës së një objekti ndërtimi;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit para përdorimit të mjeteve të punës, instrumentet matëse e niveluese që përdoren në ndërtim;
- Të përshkruajë mënyrën e sistemimit të materialeve të ndërtimit, mjeteve të punës dhe instrumenteve matëse, niveluese e gjeodezike në vendin e duhur;
- Të përshkruajë mënyrën e organizimit për kryerjen e detyrës, sipas zërit të punimit;
- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit të vendit të punës dhe e ruajtjes së higjienës personale në punë;
- Të përshkruajë mënyrën e mirëmbajtjes së veglave të punës;

- Të listojë pajisjet e mbrojtjes dhe sigurisë personale në punë duke përshkruar përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në punë, të mbrojtjes së mjedisit dhe shpëtimit nga zjarri (MSHNZ);

### **Punime përgatitore gjurmimi**

- Të rendisë hapat për planifikimin ditor të punës;
- Të përshkruajë hapat për ngritjen e kantierit;
- Të përshkruajë hapat e nivelimit në përgatitjen e sheshit të ndërtimit;
- Të përshkruajë hapat për modimin dhe vendosjen e akseve të themeleve në to;
- Të përshkruajë hapat për shënimin e konfiguracionit të gjurmimit dhe kryerjen e gjurmimit sipas kuotave;
- Të përshkruajë hapat e përforcimit të gropës për themelin në rastet e nevojshme;
- Të përshkruajë radhën e punës gjatë gjurmimit (hyrjen e mjeteve në kantier dhe në zonë e gjurmimit);

### **PUNIME TË KONSTRUKSIONIT MBAJTËS:**

#### **1. Konstruksion mbajtës me skelet prej betoni të armuar**

- Të përshkruajë hapat për shtrimin e shtresave mbi bazament për themelin prej betoni të armuar me: pllakë / trarë të kryqëzuar / plinta;
- Të përshkruajë hapat për vendosjen e përforcimit të kallëpeve, lidhjen e armaturës së hekurit dhe betonimin për themelin prej betoni të armuar me: pllakë / trarë të kryqëzuar / plinta;
- Të përshkruajë hapat për vendosjen e përforcimit të kallëpeve, lidhjen e armaturës së hekurit dhe betonimin e skeletit prej betoni të armuar: shtyllave, mureve, pllakës e trarëve të ndërkatit dhe shkallëve;
- Të përshkruajë hapat për trajtimin pas betonimit të strukturave prej betoni të armuar dhe heqjes së kallëpeve;
- Të përshkruajë hapat dhe radhën e heqjes së kallëpeve, pastrimin dhe sistemimin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën dhe kohën e përdorimit të vibratorit, si dhe llojet e vibrimit të betonit gjatë fazës së hedhjes në vepër;
- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e mureve mbushëse e ndarëse me tulla të lehtësuara të llojeve të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat për montimin/çmontimin e skelarisë;

#### **2. Konstruksion mbajtës me themele prej guri e muraturë masive prej tulle/guri/blloqe betoni**

- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e themelit dhe xokolit me gurë, si dhe të brezave kundër sizmik, kolonave prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së tipologjisë së gurëve që do të përdoren;
- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e mureve masive me tulla të llojeve të ndryshme.
- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e themelit dhe xokolit prej betoni, si dhe të brezit e shtyllave kundër sizmike prej betoni të armuar;

### **Punime çatie, mbulesash dhe tarracash**

- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e konstruksionit të çatisë sipas materialit;
- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e nënshtresave të çative sipas llojeve të mbulesës;
- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e mbulesave me tjegulla e me materiale të tjera;
- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e çatisë me kapriata të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e tarracave të llojeve të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat për shtresat hidroizoluese, termoizoluese apo izolim akustik nën shtresën e betonit apo të tjegullave;

### **Punime rifiniture**

- Të përshkruajë nyjet e instalimeve elektrike, hidrosanitare etj.;
- Të përshkruajë hapat për punimet e nënshtresave të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat për nivelimin e dysHEMEVE dhe shtrimin e tyre me mikroçimento, rezinë e materiale të tjera;
- Të përshkruajë hapat për suvatimin e tavaneve dhe mureve të brendshme e të jashtme;
- Të përshkruajë hapat për veshjen e mureve me mikroçimento, rezinë e materiale të tjera;
- Të përshkruajë hapat për veshjen e bazamakëve;
- Të përshkruajë hapat për vendosjen e pragjeve të dyerve, plintusave e davancaleve;
- Të përshkruajë hapat për ndërtimin e parapeteve;
- Të përshkruajë hapat për shtrimin e trotuareve të ndërtesës;
- Të listojë llojet e punimeve me materiale gipsi dhe materiale të tjera të ndërtimeve të thata në ndërtesa;
- Të përshkruajë hapat për veshjen e mureve të jashtme (fasadave);
- Të përshkruajë rëndësinë e patinimit dhe bojatisjes së sipërfaqeve;

### **Komunikimi**

- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të kodit të etikës në komunikim me eprorët, kolegët dhe të tjerë;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të teknikave të motivimit për arritjen e komunikimit të mirë me të tjerët;

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Ndërtim” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale si më poshtë:

### **Vizatime teknike të ndërtimit**

- Të kryejë skica të thjeshta me dorë të lirë duke përdorur shkrimin teknik;
- Të vizatojë detale të ndryshme duke vendosur përmasat, përdorur shkallët e vizatimit;

- Të vizatojë modele të thjeshta me anë të pamjeve dhe aksonometrisë;
- Të vizatojë prerje të thjeshta në modele ndërtimi dhe t'i ndajë ato në seksione;
- Të vizatojë planimetri, pamje, prerje, plan themelesh etj. për një ndërtesë të thjeshtë;
- Të skicojnë detaje të thjeshta ku zbatohen punime shënimi e hekur kthimi;
- Të vizatojë elemente konstruktive të thjeshta;

### **Materiale ndërtimi**

- Të përzgjedhë materialet drusore të përdorura në ndërtim;
- Të përzgjedhë materialet metalike dhe të kombinuara të përdorura në ndërtim;
- Të dallojë materialet prej guri natyror të përdorura në ndërtim;
- Të përzgjedhë materialet prej qeramike të përdorura në ndërtim;
- Të përzgjedhë materialet lidhëse organike dhe jo organike të përdorura në ndërtim;
- Të zbatojë recepturat e materialeve përbërëse të betonit sipas markës së dhënë dhe ta përgatisë betonin, duke veçuar kampionët për provë;
- Të zbatojë recepturat e materialeve përbërëse të llaçeve dhe t'i përgatisë ato sipas përdorimeve të tyre në punimet e muraturës, suvatimit dhe shtresave;
- Të dallojë materialet e patinimi, bojatisjes, pigmentet, tretësit dhe lëndët lidhëse, sipas përdorimit;
- Të dallojë materiale të ndryshme për shtrimin e dyshemeve;
- Të dallojë materiale të ndryshme për veshje muresh;
- Të dallojë materiale hidroizoluese, termoizoluese, akustike dhe zëizoluese sipas cilësisë të përdorimit.

### **Mekanikë ndërtimi**

- Të vizatojë sisteme të forcave plane;
- Të caktojë rezultanten e një sistemi forcash plane në mënyrë grafike;
- Të caktojë rezultanten e forcave paralele që veprojnë në të njëjtin plan e që mund të kenë kahe të njëjta apo të kundërta;
- Të llogarisë në mënyrë analitike dhe grafike reaksionet nga veprimi i forcave të çfarëdoshme plane;
- Të ndërtojë diagramën e momentit përkulës dhe forcave prerëse për trarët e drejtë;
- Të ndërtojë në mënyrë të përafërt diagramat e momenteve përkulëse dhe forcave prerëse në trarët e vazhduar;

### **Teknikë ndërtimi**

- Të skicojë prerje të themeleve dhe mureve sipas modelit të dhënë;
- Të skicojë prerje të ndërkateve dhe shkallëve sipas modelit të dhënë;
- Të skicojë pamje dhe prerje të çatisë dhe mbulesave sipas modelit të dhënë;
- Të skicojë pamje dhe prerje të tarracave;
- Të identifikojë skica të ndryshme me veshje muresh të brendshme dhe të jashtme;
- Të identifikojë skica të ndryshme me shtrim dyshemesh të brendshme dhe të jashtme;
- Të dallojë sipërfaqe të ndryshme për patinime dhe lyerje në ambiente të brendshme dhe të jashtme;
- Të dallojë llojet e makinerive për punime dhe prishje objektesh të thjeshta ndërtimore;



- Të identifikojë llojet e punimeve të rikonstruksioneve dhe shtesa objektsh të thjeshta ndërtimore;
- Të identifikojë llojet e punimeve për mirëmbajtje objektsh të thjeshta ndërtimore;
- Të skicojë konstruktive të thjeshta sipas modelit të dhënë për pllaka e ballkone konsol / trarë / plinta / shtylla / shkallë;
- Të interpretojë një tabelë të thjeshtë të specifikimit të armaturës së hekurave;
- Të kryejë punime të thjeshta të shtresave rrugore;
- Të kryejë punime në kanalizime, tubacione;
- Të kryejë punime në gjurmime, mbushje e ngritje skarpatesh;
- Të kryejë punime të thjeshta në veprat e artit;

### **Përgatitja e vendit të punës**

- Të përzgjedhë llojet e materialeve të ndërtimit që përdoren për punimet e konstruksionit mbajtës së një objekti ndërtimi;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve të ndërtimit që përdoren për punimet e rifiniturës së një objekti ndërtimi;
- Të përzgjedhë dhe të përdorë mjetet e punës dhe instrumentet matëse, niveluese e gjeodezike që përdoren për punimet e konstruksionit mbajtës së një objekti ndërtimi;
- Të përzgjedhë dhe të përdorë mjetet e punës dhe instrumentet matëse, niveluese e gjeodezike që përdoren për punimet e rifiniturës së një objekti ndërtimi;
- Të ndihmojë në montimin e skelave për punimet e konstruksionit mbajtës dhe të rifiniturës në një objekt ndërtimi;
- Të sistemojë materialet, mjetet e punës dhe instrumentet matëse e niveluese në vendin e duhur punës;
- Të përdorë pajisjet e mbrojtjes dhe sigurisë personale në punë;
- Të kryejë pastrimin e vendit të punës sipas udhëzimeve;
- Të kryejë mirëmbajtjen e veglave të punës;
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale në punë;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes nga zjarri në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;

### **Punime përgatitore gjurmimi**

- Të kryejë punime ndihmëse për ngritjen e kantierit;
- Të kryejë punime ndihmëse për nivelimin e sheshit të ndërtimit;
- Të kryejë punime ndihmëse për modimin e vendosjen e akseve;
- Të kryejë punime ndihmëse për shënimin e konfiguracionit të gjurmimit dhe kryerjen e gjurmimit dhe përforcimit të: gropës për themelin pllakë ose me trarë të kryqëzuar, gropave të plintave, transeve të themeleve të vazhduar;
- Të kryejë punime ndihmëse në përforcimin e gropës për themelin në rastet e nevojshme;
- Të kryejë heqjen e dherave të tepërta.

### **Punime të konstruksionit mbajtës:**

- Të kryejë punime ndihmëse për shtrimin e shtresave mbi bazament për themelin prej betoni të armuar me: pllakë / trarë, trarë të kryqëzuar / plinta;

- Të ndihmojë në vendosjen e përforcimin e kallëpeve, lidhjen e armaturës së hekurit dhe betonimin për themelin prej betoni të armuar me: pllakë / trarë të kryqëzuar / plinta;
- Të kryejë punime ndihmëse për vendosjen e përforcimin e kallëpeve, lidhjen e armaturës së hekurit dhe betonimin e skeletit prej betoni të armuar: shtyllave, mureve, pllakës e trarëve të ndërkatit dhe shkallëve;
- Të kryejë punime për trajtimin pas betonimit të strukturave prej betoni të armuar dhe heqjes së kallëpeve sipas udhëzimeve;
- Të kryejë punime për ndërtimin e mureve mbushëse e ndarëse me tulla të lehtësuara të llojeve të ndryshme sipas udhëzimeve.
- Të kryejë punime ndihmëse për ndërtimin e themelit dhe xokolit me gurë, si dhe të brezit kundër sizmik prej betoni të armuar;
- Të kryejë punime ndihmëse për ndërtimin e mureve masive me tulla të plota të llojeve të ndryshme.

#### **Punime çatie, mbulesash dhe tarracash**

- Të kryejë punime ndihmëse për ndërtimin çatisë me materiale e pjerrësi të ndryshme;
- Të kryejë punime ndihmëse për ndërtimin e nënshtresave dhe mbulesave me tjegulla të ndryshme e me materiale të tjera;
- Të kryejë punime ndihmëse për ndërtimin çatisë me kapriata me materiale të ndryshme;
- Të kryejë punime ndihmëse për ndërtimin e shtresave të tarracave të ndryshme;

#### **Punime rifiniture**

- Të ndihmojë për suvatimin e tavaneve dhe mureve të brendshme e të jashtme;
- Të ndihmojë për nivelimin e dysHEMEVE dhe shtrimin e tyre me pllaka;
- Të ndihmojë për veshjen e bazamakëve;
- Të ndihmojë për vendosjen e pragjeve të dyerve e dritareve dhe plintusave ;
- Të ndihmojë për ndërtimin e parapeteve;
- Të ndihmojë për shtrimin e trotuareve dhe bordurave;
- Të ndihmojë për veshjen e mureve të brendshme me materiale të ndryshme;
- Të ndihmojë për veshjen e mureve të jashtme (fasadave);
- Të kryejë punime për patinimin dhe bojatisjen e sipërfaqeve.

#### **Punime mekanike**

- Të përzgjedhë llojet e veglave dhe pajisjeve për punimet mekanike;
- Të përzgjedhë llojet e veglave matëse e niveluese;
- Të kryejë punime ndihmëse për drejtimin, shënimin, prerjen dhe hekur kthimin e shufrave të hekurit;
- Të kryejë punime të thjeshta për prerjen, sharrimin, hapjen e vrimave, perçinimin e filetimit të metaleve sipas udhëzimeve ;

#### **Komunikimi**

- Të përdorë Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të përdorë terminologjisë profesionale;

- Të zbatojë kodin e etikës në komunikim me eprorët, kolegët dhe të tjerë;
- Të përdorë teknika të motivimit për arritjen e komunikimit të mirë me të tjerët;

## **KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME**

### **Individi duhet të jetë i aftë:**

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.